

SEMANTIC PHENOMENA IN THE TERMINOLOGY OF PRE-UNIVERSITY EDUCATION TEXTBOOKS

Lura Turhani (Koburja)

“Aleksandër Xhuvani” University of Elbasan, Albania, Lura.Turhani@uniel.edu.al

ORCID ID: 0009-0009-0199-2308

Abstract: This paper examines the semantic phenomena that appear in the terminology of pre-university education (PUE) textbooks in Albanian, viewing them at the meeting point between the general lexicon and specialised knowledge. As a system of signs corresponding to the concepts of a field, terminology ideally aims at univocity, precision and a one-to-one link between concept and designation; yet in the real use of school texts these features are confronted with semantic phenomena inherited from everyday language, such as polysemy, synonymy, homonymy and antonymy. The theoretical framing moves from the classical idealisation of the term, which requires a one-to-one concept–designation bond (Wüster, 1979; Cabré, 1999), towards the contemporary view that treats the term as a multidimensional unit embedded in language and communication (Cabré, 2023; Faber & L'Homme, 2022). Drawing on the Communicative Theory of Terminology, the study first addresses the semantic motivation and demotivation of the term, and then analyses each phenomenon in turn. The material follows a corpus of naming units drawn from textbooks of different disciplines — linguistics, mathematics, physics, chemistry, biology, geography and natural science — processed through a descriptive-analytical, corpus-based method combining semasiological and onomasiological perspectives. The results show that terminological polysemy preserves a sharper conceptual boundary than the general lexicon and functions as a controllable semantic micro-system; that synonymy remains the most unfavourable phenomenon for the didactic text, fed mainly by the parallel circulation of the Albanianised term and the borrowed one; that terminological homonymy is rare and its boundary with polysemy is indeterminate, which agrees with recent findings presenting polysemy as a continuum between sense identity and homonymy-like unrelatedness (Haber & Poesio, 2024); and that antonymy, unlike the other three, is an acceptable and even useful phenomenon, since the juxtaposition of opposites serves as a conceptual differentiator. From the standpoint of the linguistic quality of the school text, the uncontrolled presence of synonymy and homonymy is assessed as an obstacle to the accurate fixing of concepts by pupils. The paper argues that the didactic-scientific register requires standardised, univocal terminology, and that terminological planning of textbooks should be seen as a joint linguistic and pedagogical task.

Keywords: terminology, lexical semantics, polysemy, synonymy, homonymy, antonymy, textbooks.

DUKURI SEMANTIKE NË TERMINOLOGJINË E TEKSTEVE MËSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Lura Turhani (Koburja)

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Shqipëri, Lura.Turhani@uniel.edu.al

ORCID ID: 0009-0009-0199-2308

Abstrakt: Punimi shqyrton dukuritë semantike që shfaqen në terminologjinë e teksteve mësimore të arsimit parauniversitar (APU) në gjuhën shqipe, duke i vështuar në pikëtakimin mes leksikut të përgjithshëm dhe leksikut të specializuar. Terminologjia, si sistem shenjash që u përgjigjen koncepteve të një fushe dijeje, synon idealisht njëkuptimësinë, përpikërinë dhe lidhjen njësh të konceptit me emërtimin; megjithatë, në përdorimin real të teksteve shkollore këto tipare vihen përballë dukurive semantike të trashëguara nga gjuha e përditshme, si polisemia, sinonimia, homonimia dhe antonimia. Kualia teorike ndërtohet mbi kalimin nga idealizimi klasik i termit, që kërkon njësh koncept–emërtim (Wüster, 1979; Cabré, 1999), te qasja e sotme që e sheh termin si njësi shumëpërmasore, të ngulitur në gjuhë e në komunikim (Cabré, 2023; Faber & L'Homme, 2022). Duke u mbështetur në teorinë komunikuese të terminologjisë, studimi trajton fillimisht motivimin dhe demotivimin semantik të termit, e më pas analizon secilën dukuri veç e veç. Materiali ndjek një korpus njësisish emërtuese të vjela nga tekstet e disiplinave të ndryshme — gjuhësi, matematikë, fizikë, kimi, biologji, gjeografi e dituri natyre — të përpunuar me metodë përshkruese-analitike, që ndërthur këndvështrimin semasiologjik dhe atë onomasiologjik. Rezultatet tregojnë se polisemia terminologjike ruan një kufi më të prerë kuptimor sesa leksiku i përgjithshëm dhe funksionon si mikrosistem semantik i kontrollueshëm; se sinonimia mbetet dukuria më e pafavorshme për tekstin didaktik, e ushqyer kryesisht nga bashkëqarkullimi i termit të shqipëruar me atë të huazuar; se homonimia terminologjike është e rrallë dhe kufiri i saj me poliseminë del i papërcaktuar, gjë që përkon me gjetjet e reja që e paraqesin poliseminë si vazhdimësi mes njësisë kuptimore dhe palidhshmërisë homonimike (Haber & Poesio, 2024); dhe se antonimia, ndryshe nga tri të parat, është dukuri e pranueshme e

madje e dobishme, ngase pranëvënia e të kundërtave shërben si mjet diferencimi konceptor. Nga pikëpamja e cilësisë gjuhësore të tekstit shkollor, prania e pakontrolluar e sinonimisë e homonimisë vlerësohet si pengesë për ngulitjen e saktë të koncepteve te nxënësit (krh. Ajdini-Murtezi, Saliu, & Saliu, 2022). Punimi mbron qëndrimin se regjistri didaktik-shkencor kërkon terminologji të standardizuar e të njëkuptimshme, dhe se planifikimi terminologjik i teksteve duhet parë si detyrë e përbashkët gjuhësore e pedagogjike.

Fjalë kyçe: terminologji, semantikë leksikore, polisemi, sinonimi, homonimi, antonimi, tekste mësimore.

1. HYRJE

Termi zë një vend të veçantë në sistemin leksikor: ai është njësi emërtuese e ngarkuar me një përmbajtje konceptore të përcaktuar brenda një fushe dijeje dhe, si i tillë, u nënshtrohet një sërë kërkesash idealisht të rrepta — njëkuptimisë, përpikërisë, lidhjes njësh mes shenjës dhe konceptit, si dhe një shkalle motivimi (Wüster, 1979; Cabré, 1999). Teoria bashkëkohore e ka zbutur këtë idealizim: terminologjia e sotme e njëh termin si njësi shumëpërmasore, të ngulitur në gjuhë e në komunikim, që nuk shkëputet nga leksiku i përgjithshëm prej të cilit shpesh buron (Cabré, 2023; Faber & L'Homme, 2022). Ky ripozicionim teorik e bën të domosdoshme vëzhgimin e dukurive semantike jo si „gabime” të terminologjisë, por si prirje të natyrshme të gjuhës që hyjnë në tension me funksionin e termit.

Tekstet mësimore të arsimit parauniversitar përbëjnë një situatë komunikuese të veçantë: nuk janë as tekste rreptësisht shkencore për specialistë, as ligjërime të përditshme, por një regjistër didaktik-shkencor ku termi duhet të jetë njëherazi i saktë dhe i përvetësueshëm nga një lexues në formim. Çdo luhatje semantike ka pasoja të drejtpërdrejta mbi qartësinë e mësimin dhe mbi ngulitjen e vetëdijshme të koncepteve te nxënësit; kërkime të reja mbi gjuhën e teksteve shkollore e evidentojnë saktësinë terminologjike si një ndër tiparet më të cenueshme të tyre (Ajdini-Murtezi et al., 2022).

Punimi synon të përgjigjet në tri pyetje: (a) cilat dukuri semantike shfaqen më dendur në terminologjinë e teksteve të APU-së dhe cilat janë shkaqet; (b) si sillet secila dukuri në kalimin nga leksiku i përgjithshëm në atë terminologjik; dhe

(c) cilat prej tyre e cenojnë e cilat e mbështesin funksionin didaktik. Teza jonë udhëheqëse është se këto dukuri nuk janë njësoj të dëmshme: ndërsa sinonimia dhe homonimia e dobësojnë njëkuptimësinë, polisemia e kontrolluar dhe antonimia mund të shndërrohen në burim qartësie konceptore — diferencim që, sipas gjykimit tonë, duhet të qëndrojë në themel të çdo ndërhyrjeje redaktuese në tekste.

2. METODOLOGJIA

Studimi ka natyrë përshkruese-analitike dhe mbështetet në një korpus njësisht emërtuese të vjela nga tekstet mësimore të APU-së në gjuhën shqipe, në disiplina të ndryshme — gjuhësi, matematikë, fizikë, kimi, biologji, gjeografi, dituri natyre dhe shkencat e tokës — që dukuritë të vështrohen edhe brenda një fushe, edhe në rrafshin ndërterminologjik. Njësitë ilustruese identifikohen përmes shkurtesave konvencionale të lëndës dhe klasës (Gj. = gjuhësi, M. = matematikë,

F. = fizikë, K. = kimi, B. = biologji, D.N. = dituri natyre, Ggeo. = gjeografi, Shk.T. = shkencat e tokës; numri tregon klasën), sipas praktikës së burimit parësor.

Përpunimi ndjek dy hapa. Së pari, njësitë vilen sistematikisht dhe grupohen sipas tipit të marrëdhënies semantike (motivim/demotivim, polisemi, sinonimi, homonimi, antonimi). Së dyti, çdo grup analizohet nga pikëpamja e strukturës (term-fjalë, term-togfjalësh, kompozitë), e prejardhjes (term shqip vs. i huazuar) dhe e pasojës funksionale për tekstin didaktik. Qasja, e ndërthurur semasiologjikisht (nga forma te kuptimi) dhe onomasiologjikisht (nga koncepti te emërtimi), përkon me teorinë komunikuese të terminologjisë (Cabré, 2023) dhe me perspektivat e sotme që theksojnë variacionin e shumëpërmasorësinë e njësisë terminologjike (Faber & L'Homme, 2022); për interpretimin brenda shqipes mbështetemi edhe në traditën leksikologjike (Thomai, 2006; Duro, 2009). Korpusi është ilustrues e jo shterues, prandaj përfundimet kanë vlerë cilësore-përshkruese e jo statistikore.

3. MOTIVIMI DHE DEMOTIVIMI SEMANTIK I TERMIT

Në motivimin semantik, kuptimi fillestar i fjalës nuk ruhet më i plotë: për të emërtuar një koncept, terminologjia zgjedh një emërtim nga një fushë tjetër duke u nisur nga një ngjashmëri forme a funksioni. Kështu, pjesë të trupit të njeriut si *kokë* ose *gjymtyrë* terminologjizohen dhe tiparet e tyre fillestare zbehen brenda strukturës së re. Meqë leksiku terminologjik zhvillohet paralelisht me shkencën, rrallë arrihet një veshje gjuhësore që t'i respektojë njëherazi të gjitha vetitë e termit.

Nga kjo lind demotivimi: hapësira mes strukturës konceptore dhe asaj gjuhësore zbehet me kohën, sidomos kur njohuritë e reja e ndryshojnë vetë konceptin. Çifti *lindja e diellit / perëndimi i diellit*, i motivuar mbi një përfytyrim parashkencor, sot ndihet i pamotivuar pa e humbur funksionin. Sipas gjykimit tonë, ky është argument me peshë kundër idealizimit të motivimit: termat e pamotivuar janë shpesh më të qëndrueshëm, sepse nuk rrezikojnë të dalin „të palogjikshëm” kur koncepti evoluon. Njëkuptimësia që na intereson në tekstin shkollor nuk është ajo absolute e etimologjike, por një njëkuptimësi relative brenda një fushe dijeje dhe një

kohe të caktuar (Cabr , 2023). Pik risht v shtir sia p r t  p rcaktuar qart  p rmbajtjen dhe shenj n e termit nxjerr n  pah polisemin , homonimin  e sinonimin , t  cilave u shtohet antonimia si dukuri me shenj  t  kund rt vler simi.

4. POLISEMIA

Me polisemi kuptojm  shum kuptim sin  e n  em rtimi, pra p rdorimin e s  n j t s form  n  disa kuptime mes t  cilave lidhja kuptimore mbetet e dallueshme. N  leksikun e p rgjithsh m ajo  sht  e shpesht ; n  terminologji shihet zakonisht si shprehje e pamjaftueshm ris  shenjore t  gjuh s. Dallimi thelb sor, sipas mendimit ton , nuk q ndron te prania e polisemis , por te natyra e kufirit kuptimor: n  leksikun e p rgjithsh m kalimi mes kuptimeve  sht  i rr shqitsh m, kurse n  terminologji kufiri  sht  i prer  dhe konteksti disiplinor e „mbyll” termin brenda n  rrethi konceptor.

K shtu n esia *rr nj * specializohet ve as n  botanik , anatomi, gjuh si (Gj.), matematik  (M. 6) e kimi (K.), por lidhja kuptimore mbetet e dukshme sepse ruhen p rb r sit e konceptit fillestar. Po ashtu *nyj * del me kuptim t  p rgjithsh m dhe me kuptime terminologjike n  botanik , anatomi e n  gjuh si (Gj.), ku sh non pjes z n q  tregon shquarsin , nd rsa *morfologji* ndan kuptimin gjeologjik nga ai gjuh sor „deg  e gramatik s” (Gj.). N  fushat ekzakte, n esi si *fush * (F. 11 / Gjeo. 6), *k nd* (F. 11 / M. 5) apo *rreze* (F. 11 / M. 6) dalin si mikrosisteme semantike ku secili kuptim ve ohet p rmes togfjal shave t  q ndruesh m (p.sh. *fush  magnetike* kundrejt *fush  aluvionale*).

Ky p rcaktim i qart  i kufijve m  lejon t  mbroj n  q ndrim q  devijon nga vler simi tradicional negativ: n  tekstin didaktik, polisemia e kontrolluar nuk  sht  domosdoshm risht e d mshme. Kur teksti e b n t  dukshme lidhjen e brendshme mes kuptimeve dhe e ankron secilin n  kontekstin disiplinor, polisemia mund t  sh rbej  si ur  njoh se q  e ndihmon nx n sin t  lidh  dijen e re me p rvoj n gjuh sore paraprake. Rreziku lind vet m kur kufiri konceptor mbetet i pashprehur. Kjo pik pamje gjen mb shtetje te k rkimet q  e paraqesin polisemin  si vazhdim si shkall zore mes identitetit t  kuptimit dhe palidhshm ris  s  tipit homonimik (Haber & Poesio, 2024).

5. SINONIMIA

Sinonimia paraqitet kur dy ose m  shum  em rtime i p rgjigjen t  n j tit koncept, duke e b r  t  shk mbyesh m (p.sh. *automjet* – *makin *). Ndryshe nga polisemia, ajo hyn n  kund rshti t  drejtp rdrejt  me natyr n e termit: n kuptim sia dhe qart sia ndihen „t  rrezikuara” sa her  n  koncept mbulohet nga m  shum  se n  em rtim. N  tekstet e APU-s  shkaku kryesor  sht  bashk qarkullimi i termit t  shqip ruar me at  t  huazuar ose nd rkomb tar: *p rshtatje* – *adaptim* (B. 6), *ve ues* – *izolues* (F. 11), *brejtje* – *korrozion* (K. 10), *kurba t  relievit* – *izohipse* (Shk. T. 1).

N  sistemin terminologjik t  gjuh sis  dukuria  sht  po aq e pranishme: *shum kuptim si* – *polisemi* (Gj. 8), *fjal  e p rb r * – *kompozit * (Gj. 5), *em r vendbanimi* – *oikonim* (Gj. 8), *gjymtyr  n j far she* – *gjymtyr  homogjene* (Gj. 9) dhe *dialekti i veriut* – *geg rishnja* (Gj. 4). Nga pik pamja strukturore, pjesa m  e madhe e dysor ve jan  togfjal sha, ku gjymtyra p rcaktuese sh rben si plot sues kontekstor i konceptit.

Vler soj se sinonimia  sht  dukuria semantike m  e pap rshtatshme p r tekstin shkollor. Nd rsa n  ligj rimin e p rgjithsh m sinonimet e pasurojn  shprehjen, n  n j  tekst didaktik ato e ngarkojn  nx n sin me dy etiketa p r n j  koncept dhe e dob sojn  lidhjen n j sh shenj -koncept q  m simi k rkon t  ngulit . Teoria komunikuese e n j h variacionin si tipar real t  p rdorimit terminologjik (Cabr , 2023), por pik risht ky pranim e b n m  urgjente detyr n e planifikimit: teksti m simor  sht  nd r zhanret ku variacioni duhet zbutur me vet dije. Konkurrenca mes termit shqip dhe atij t  huaj tregon edhe kahun e zhvillimit t  n j  terminologjie; megjithat , gjat  bashk jetes s s  t  dy termave, teksti duhet t  jap  sinjale t  qarta se cili em rtim  sht  i parap lqyer —  shtje standardizimi q  i takon po aq gjuh sis  sa edhe politik s arsimore. (Turhani, 2025)

6. HOMONIMIA

Homonimia shfaqet kur em rtime t  ngjashme p r nga forma nuk ruajn  asnj  ngjashm ri thelb sore me konceptet q  em rtojn . Kufiri mes homonimis  dhe polisemis  varet nga aft sia e fol sve p r t  dalluar apo jo n j  lidhje kuptimore mes formave t  n j ta: homonimia fillon aty ku kjo lidhje nuk perceptohet m . N  leksikun nd rterminologjik homonimia takohet rrall ; ajo lind zakonisht kur i n j ti em rtim ngrihet si term n  fusha t  palidhura, si te *rr nj * (e bim s) kundrejt *rr nj * katrore (M. 6), *trup* (i njeriut) kundrejt *trup* gjeometrik (M. 9), apo — n  pik takim me gjuh sin 

— *shprehje* (gjuh sore) (Gj.) kundrejt *shprehje* algjebrike (M.) dhe *rregull* (gramatikore) (Gj.) kundrejt *rregulla e trashit* (M.).

Kufiri i pap rcaktuar mbetet nd r  shtjet m  t  diskutueshme t  semantik s leksikore. Nga n j  an , polisemia mund t  v shtrohet si e „rr gjuar” n  homonimi kur larg sia kuptimore brenda n j  shenje b het e atill  sa forma interpretohet si dy shenja t  ndryshme; nga ana tjet r, mund t  pranohet vet m polisemia, sepse kuptimet, sado t  larg ta, lidhen n  n j  far  m nyre. Sipas gjykimit ton , p r q llime didaktike vlera praktike anon nga pranimi i t  dyja dukurive: n  glosar t shkollor , rastet v rtet homonimike duhet t  pasqyrohen si

zëra të veçantë, që nxënësi të mos kërkojë kot një lidhje kuptimore atje ku nuk ka. Kjo përputhet me gjetjen se ngjashmëria kuptimore shtrihet në një spektër nga identiteti i kuptimit deri te palidhshmëria homonimike (Haber & Poesio, 2024), dhe mbështet parimin se në terminologji parësore mbetet përmbajtja, e jo forma.

7. ANTONIMIA

Antonimia shpreh marrëdhënie kundërvënieje semantike mes fjalëve të së njëjtës kategori leksiko-gramatikore. Ndryshe nga tri dukuritë e mëparshme, ajo është e pranueshme e madje e pëlqyeshme në dijen terminologjike, sepse pranëvënia e të kundërtave shërben si mjet diferencimi konceptor: lidhjet e kuptimeve të kundërta i zbulojnë njëra-tjetrës tiparet dalluese. Në tekstet e APU-së, çiftet antonimike në nivel fjale në sistemin e gjuhësisë janë veçanërisht të pasur — *frymor*

– *jofrymor* (Gj. 2), *zgjerim* – *ngushtim* (Gj. 5), *parashtesë* – *prapashtesë* dhe *bashkërenditje* – *nënrenditje* (Gj. 6), *sinonim*

– *antonim* (Gj. 6), *temë* – *remë* (Gj. 8) — krahas atyre nga fushat ekzakste, si *metal* – *jometal* (K. 8), *katodë* – *anodë* (F. 8) e *pol pozitiv* – *negativ* (F. 6).

Numrin më të madh e përbëjnë mbiemrat cilësorë që krijojnë kundërvënie brenda togfjalëshave terminologjike: *trajtë* e *shquar* – e *pashquar* (Gj. 3), *mbiemër* i *nyjshëm* – i *panyjshëm* (Gj. 4), *ligjëratë* e *drejtë* – e *zhdrejtë* (Gj. 8), *fjali* *pohore* *mohore* (Gj. 3), *kallëzues* *foljor* i *thjeshtë* – i *përbërë* (Gj. 7). Nga ana strukturore, çiftet ndahen në ato me rrënjë të njëjtë, ku kundërvënia realizohet me parashtesa mohuese a me funksion antonimik (i *nyjshëm* – i *panyjshëm*, *shquarsi* – *pashquarsi* [Gj. 9], *barazim* – *mosbarazim* [M. 5]), dhe ato me rrënjë të ndryshme (*pohore* – *mohore*, *temë* – *remë*, *prehje*

– *lëvizje* [F. 7]).

Mbizotërimi i mbiemrave antonimë nuk është, sipas mendimit tonë, i rastësishëm: shkenca përparon duke klasifikuar objekte sipas pranisë a mungesës së një cilësie, prandaj antonimia mbiemërore është shprehje e drejtpërdrejtë gjuhësore e këtij operacioni njohës. Në planin didaktik antonimia është aleate: kur teksti i paraqet konceptet në çifte të kundërta, ai lehtëson strukturimin e njohurive dhe kujtesën e nxënësit. Prandaj, ndryshe nga sinonimia, ajo nuk ka nevojë të

„zbutet”, por të shfrytëzohet me vetëdije didaktike.

8. PËRFUNDIME

Analiza e leksikut ndërterminologjik të teksteve mësimore të APU-së dëshmon se proceset leksiko-semantike të gjuhës së përgjithshme shfaqen, shpesh në formë të shndërruar, edhe në terminologji, me shkaqe të përafërta nëpër fusha të ndryshme dijeje. Megjithatë, vlerësimi i tyre nuk mund të jetë i njëtrajtshëm. Studimi mbrojtë tezën se këto dukuri kanë ndikim të diferencuar mbi funksionin didaktik: polisemia, falë kufirit të prerë konceptor, funksionon si mikrosistem i kontrollueshëm dhe mund të kthehet në burim qartësie; antonimia është e dobishme, sepse pranëvënia e të kundërtave është vetë mekanizmi i klasifikimit shkencor; përkundrazi, sinonimia mbetet dukuria më e pafavorshme, ndërsa homonimia, edhe pse e rrallë, kërkon trajtim të veçantë leksikografik.

Nga këtu rrjedh qëndrimi ynë përmbyllës: regjistri didaktik-shkencor i teksteve shkollore kërkon terminologji të standardizuar e të njëkuptimshme, dhe planifikimi terminologjik i tyre duhet parë si detyrë e përbashkët e gjuhësisë e e pedagogjisë. Redaktimi terminologjik nuk mund të mjaftohet me pastrimin mekanik të „gabimeve”; ai kërkon një kriter semantik që dallojë mes dukurive që duhen zbutur (sinonimia, homonimia e pasqaruar) dhe atyre që mund të shfrytëzohen (polisemia e kufizuar, antonimia). Perspektivat e sotme teorike, që e njohin termin si njësi shumëpërmasore e komunikuese (Cabré, 2023; Faber & L'Homme, 2022), e mbështesin një qasje të tillë të ndjeshme ndaj kontekstit. Kërkime të mëtejshme, mbi një korpus më të gjerë e me matje sasiore, do ta thelloheshin këtë tablo dhe do ta shndërronin në udhëzues konkret për autorët e teksteve shkollore.

REFERENCA

- Ajdini-Murtezi, L., Saliu, B., & Saliu, H. (2022). Language errors in translated texts of primary education. *Albanologjia: International Journal of Albanology*, 9(17–18).
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Turhani, L. (2025). *Probleme të përvetësimit të terminologjisë shkencore-teknike në sistemin tonë arsimor*, Në konferencën “Prurje shkencore në mendimin gjuhësor shqiptar në fushën e semantikës leksikore, gramatikore, diskursive, si dhe në dijen terminologjike”. Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë. (Aktet e konferencës në proces botimi.)
- Arntz, R., Picht, H., & Mayer, F. (2009). *Einführung in die Terminologiearbeit*, Georg Olms Verlag, Hildesheim.
- Cabré, M. T. (1999). *Terminology: Theory, methods and applications*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.
- Cabré, M. T. (2023). *Terminology: Cognition, language and communication* (IVITRA Research in Linguistics and Literature, Vol. 36). Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.

- Duro, A. (2009). *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Duro, A. (2003). *Përdorimi i termave në ligjërimin shkencor-teknik në kushtet e konkurrencës sinonimike*, në “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë.
- Faber, P., & L'Homme, M.-C. (Eds.). (2022). *Theoretical perspectives on terminology: Explaining terms, concepts and specialized knowledge*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.
<https://doi.org/10.1075/tlrp.23>
- Haber, J., & Poesio, M. (2024). Polysemy—Evidence from linguistics, behavioral science, and contextualized language models. *Computational Linguistics*, 50(1), 351–417.
- Islamaj, Sh. (1985). *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë.
- Lyons, J. (1977). *Semantics* (Vëll. 1–2). Cambridge: Cambridge University Press. Pasho, H., (2005). *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Sager, J. C. (1990). *A practical course in terminology processing*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.
- Thomai, J. (2006). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet Toena.
- Wüster, E. (1979). *Einführung in die allgemeine Terminologielehre und terminologische Lexikographie*. Wien/New York: Springer.